



Nr. 1290 Prot.

Fier, më 21 . 08 . 2025

Në mbështetje të Ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, udhëzimit nr. 19, datë 29.08.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 03.05.2024 "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit "Mësues për Shqipërinë", i ndryshuar, kreu IV pika 13/1, ju njoftojmë si mëposhtë:

Kandidatët e interesuar për punësim të cilët nuk janë pjesë e portalit “Mësues për Shqipërinë”, të paraqesin në rrugë postare në ZVAP Fier dokumentacionin për punësim nga jashtë si mëposhtë :

1. Kartë identiteti
2. Kërkesë për punësim nga jashtë
3. Diplomë dhe listë notash
4. Dëshmi kualifikimi (nëse ka)
5. Dëshmi të gjuhëve të huaja (nëse ka)
6. Librezë pune (nëse ka)
7. Dëshmi penaliteti
8. Deklaratë për gjendjen gjyqësore

Dokumentacioni i sipërcituar të përcillet i njëhsuar me origjinalin.

Afati për dorëzimin e dokumenteve të sipërcituara është data 29.08.2025

Sqarim: Punësimi i kandidatëve të interesuar lidhur me këtë procedurë do të bëhet vetëm në rastet kur nuk ka kandidatë në portalin “Mësues për Shqipërinë” në profilet e kërkuara dhe në profilet e përafërta dhe as kandidatë në nivel DRAP-i.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTOR

Miglena Sofronova

